REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorezuar<br>Primljeno/Prodato<br>Recieved/Delivery | 28.04 | 2021 | viti<br>god<br>year |
|---|---|---|---|
| Organ /Njesia<br>Organ /Jedinica<br>Org /Unit | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SHMSHCK | 2039 | 2021 | 1/3 |


**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr. 144/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.144/2021 të datës 16.03.2021, të ankueses me adresë banimi Fshati Ndërkombëtar Nr.98, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridik "*transfer*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar me ankesën A.nr.144/2021 të datës 16.03.2021 të parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja nëpunëse civile në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 16.03.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1179/2021 të regjistruar me numër A.nr.144/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër Ref. 43/2020 të datës 23.02.2021 të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemimin e ankueses në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit për Administratë në Akademinë Diplomatike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 22.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (me tej MPJD). Ndërsa Këshilli më datë 30.03.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga MPJD-ja se bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova**: Ankesën e ankueses parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli: 1179/2021; Vendimin e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Ref.43/2020 të datës 23.02.2021; Vendimin me numër Nr.03/65 të datës 08.03.2021 për Themelimin e Akademisë Diplomatike; Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin

Civil të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me titujt e vendeve të punës me vendimin Nr.09 të datës 21.02.2021 nga ministri i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesën e ankueses për mbajtjen e seancës e dërguar përmes e-maili në adresë elektronike të pranimit të ankesave në Këshill ankesa.kpmshck@rks-gov.net e protokolluar me numër:1428/2021 të datës 26.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.03.2021 me numër protokolli:1295/2021; Përgjigja në kërkesë e datës 30.03.2021 me numër protokolli:1470/2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim në Akademinë Diplomatike; E-mailin e datës 25.01.2021 dërguar nga për ne korrespodencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-maili i datës 07.04.2021 dërguar nga për më korrespodencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Përshkrimin e detyrave për pozitën e Drejtorit të Drejtoratit për Administratë në Akademinë Diplomatike i datës 17.04.2015; Strukturën organizative të Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Procesverbalin mbi seancën dëgjimore të datës 19.04.2021 me provat e bashkangjitura të pranuara nga Kolegji gjatë seancës; Shkresën e parashtruar nga ankuesja në seancën dëgjimore të datës 19.03.2021 në përmbajtje prej 6 (gjashtë) faqesh; Rekomandimin për znj. e datës 13.05.2019; Rekomandimin e datës 08.07.2019; Diplomën e lëshuar nga Rochester Instuitute of technology e datës 20.11.2010; Çertifikatën e lëshuar nga National Albanian American Council e datës 13.12.2002; Certifikatën lëshuar nga Ëorld Bank Group; Shkresën e datës 02.12.2013; Shkresën e datës 17.05.2004; E-mailin e dërguar nga ankuesja për Sekretarin e ministrisë bashkangjitur me korrespodencën prej 2 (dy) faqesh, Shkresën e titulluar reagim ndaj vendimit Nr. Ref.43/2021 të datës 23.02.2021; Shkresa e datës 19.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas seancës dëgjimore të datës 19.04.2021 dhe pas ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës së *është shqyrtuar paraprakisht, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesja me datë 14.12.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokolli 227 të datës 08.12.2020, të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me sistemimin e përkohshëm të ankueses në pozitën „Zyrtare e Lartë për Çështje Politike", pas kthimit nga shërbimi diplomatik " Këshilltare" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë/ Itali.

Këshilli përmes Vendimit me numër A.416/2020 të datës 11.02.2021 ka pranuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankueses së datës 14.12.2020 dhe ka detyruar organin e punësimit, që të sistemoj ankuesen në njërin nga tri pozita t e lira udhëheqëse, të konfirmuara nga MPJD-ja.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e Vendimit të Këshillit me numër A.416/2020 të datës 11.02.2021, me Vendimin Nr. ref.43/2021 të datës 23.03.2021, ka bërë sistemimin e ankueses në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit për Administratë në Akademinë Diplomatike, duke filluar nga data 23.02.2021.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill e precizuar në seancën dëgjimore të datës 19.04.2021. ka kundërshtuar Vendimin Nr. ref.43/2021 të datës 23.03.2021 të Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Vendimin me numër A.Nr.416/2020 të datës 11.02.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimet e atakuara me ankesë janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e

Nëpunësve Civil; Ligjin Nr.06/L-113 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërorë dhe Agjencive të Pavarura, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/65 të datës 08.03.2012 për Themelimin e Akademisë Diplomatike të Kosovës, si dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë, i plotësuar dhe ndryshuar me datë 21.02.2018.

Andaj, nisur nga fakti së objekti i ankesës me numër A.nr.144/2011 e datës 16.03.2021, bazohet në të njëjtën gjendje faktike sikurse objekti i ankesës së parashtruar në Këshill me datë 14.12.2020, e për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.Nr.416/2020 të datës 11.02.2021, Kolegji në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht neni 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: 1.*"Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"*, ka konstatuar që të përfundohet procedimi administrativ i iniciuar nga ankuesja përmes ankesës A.nr.144/201 të datës 16.03.2021.

Në vështrim të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se:1. *Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës* dhe nenin 22 ku përcaktohet se: *1.Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. 2.Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit*, Kolegji ka konstatuar se vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil janë vendime të ekzekutueshme dhe së pala e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, e si rrjedhojë ankuesja në rast të pakënaqësisë me Vendimin e Këshillit A.Nr.416/2020 të datës 11.02.2021 ka mundur të filloj konflikt administrativ ashtu siç është udhëzuar në pjesën e Këshillës Juridike.

Bazuar në rrethanat si me lart, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimin nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente-Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**Lënda me numër A.nr.144/2021**

**Flakron Gashi**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Ardita Haxhnikaj-Demi**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankueses*
- *Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*